



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Ligji Nr. 05/L-111

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE
PËR INVESTIME PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË LINJËS
HEKURUDHORE 10**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS
EVROPIANE PËR INVESTIME PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË
LINJËS HEKURUDHORE 10**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen Financiare, e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10, më 8 dhjetor, 2015.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja Financiare e kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10, e lidhur me datë 8 dhjetor 2015, në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën e këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja Financiare e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10, e lidhur me datë 8 dhjetor 2015, në Prishtinë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -111
4 gusht 2016

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kadri VESELI